

# NJË KOHË E QETË

---

**Pikturat: Tim Shirey**  
**Përktheu: Ana Memi**

**Shkruar nga:**  
**CEF Qendra Evropiane**  
**Kilchzimmer**  
**CH - 4438 Langenbruck**  
**Zvicër**

JU LUTEMI VINI RE!

Vizualet për këtë seri mund të blihen në pjesën më të madhe të zyrave të BUF-it dhe në dyqanet në internet. Për një listë të zyrave të BUF-it dhe dyqaneve në internet në Evropë, ju lutemi vizitoni [www.teachkids.eu/al](http://www.teachkids.eu/al) dhe kliko mbi “Vendet”.



**BUFESH**

BASHKËSIA E UNGJILLIZIMIT  
TË FËMIJËVE E SHQIPËRISË®

Copyright © 1983, 1994 European Child Evangelism Fellowship

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përdorur me leje.

Mund të riprodhohet vetëm për përdorim personal, shërbese,  
jofitimprurës ose jo-komercial. Vizitoni [www.teachkids.eu/al](http://www.teachkids.eu/al)  
për më shumë detaje mbi lejen e përdorimit.

MËSUES, kjo broshurë është shkruar për t'ju ndihmuar për të mësuar nxënësit tuaj sesi të kenë një kohë personale adhurimi ditë për ditë: një "Kohë të Qetë."

Këto janë sugjerime për njëmbëdhjetë javë. Koha e mësimit do të zërë rreth 10 minuta çdo javë. Nëse shikoni që kapitujt janë shumë të gjatë, mund t'i ndani ato në dy pjesë.

Kujtoni që shumë besimtarë të rritur nuk kanë një kohë të rregullt adhurimi ose përkushtimi. Edhe nëse prindërit e nxënësve tuaj janë të krishterë, ata mund të mos japin një shembull në këtë pjesë të jetës së tyre. Ju, mësues, mund të jeni modeli më i mirë për fëmijët. Sigurohuni që ju kënaqeni me të vërtetë me privilegjin për të takuar Zotin çdo ditë. Ndërsa Zoti ju bekon nëpërmjet miqësisë me Të, flisni me fëmijët me entuziazëm për përvojat tuaja. Shembulli juaj është po aq i rëndësishëm sa udhëzimet tuaja!

## **Pjesa 1**

### **Çfarë është një Kohë e Qetë?**

*(Përpara se të tregoni kapakun)*

Sa prej jush mendojnë që ju jeni detektivë shumë të mirë? Një dedektiv i mirë bën vrojtime ose mbikëqyr - kjo do të thotë që ai shqyrton nga afër çdo provë që vendoset përpara tij. Ai gjithashtu dëgjon mirë çfarë thuhet me qëllim që të gjejë të dhëna që i nevojiten për t'iu përgjigjur pyetjeve. Pyetjet që ne do të bëjmë do të na ndihmojnë ne të mësojmë për diçka shumë të rëndësishme për një të krishterë që do të rritet. Unë madje kam edhe një libër të dhënash në të cilin secili nga ju të mbajë shënime për të kujtuar se çfarë ne zbulojmë çdo herë.

*(Mësues, sigurojini secilit prej nxënësve tuaj një fletore të vogël.)*

*(Tregoni kapakun)*

Ja ku është e dhëna jonë e parë. Tani shqyrtoni nga afër. A mendon që djali në këtë figurë është një i krishterë? *(Po).*

Si mund ta dallosh? *(Ai është duke u lutur dhe duke lexuar Biblën e tij.)*

Tani mendo me të vërtetë për pyetjen tjetër përpara se t'i përgjigjesh. A të bën ty leximi i Biblës dhe lutja një të krishterë? *(Jo)*

Nëse kjo nuk të bën ty një të krishterë, atëherë çfarë të bën? *(Vendosja e besimit tek Zoti Jezus si Shpëtimtarin tënd.)*

*(Mësues, prano çdo përgjigje që do të nënkuptojë të njëjtën gjë dhe përdor një varg Biblik për të mbështetur përgjigjet e fëmijëve, p.sh. Gjoni 3:16; Veprat e Apostujve 16:31.)*

Shumë mirë. Tani më lejoni t'ju jap disa informacione të rëndësishme për këtë djalë. Ai e ka pranuar tashmë Zotin Jezus si Shpëtimtarin e tij. A mund të më shpjegosh se çfarë është ai duke bërë? *(Duke pasur një Kohë të Qetë.)*

Po, ky djalë e do Zotin Jezus, dhe kështu që zgjohet herët (është ora 7 e mëngjesit) për të kaluar kohë me Të përpara se të jetë i zënë me gjëra të tjera.

Për disa javë të tjera ne do të zbulojmë disa të dhëna që do të na tregojnë sesi të kemi një Kohë të Qetë - një kohë të veçantë që ne kalojmë me Perëndinë çdo ditë. Nëse ti ke besuar në Zotin Jezus si Shpëtimtarin tënd, atëherë edhe ti ke nevojë të konsiderosh që të fillosh të kesh një Kohë të Qetë çdo ditë.

*(Përpara se të ktheheni në faqen 1)*

Ne duam të zbulojmë disa të dhëna që do të na ndihmojnë të dimë çfarë është një Kohë e Qetë. Në këtë faqe tjetër ne do të gjejmë të dhënën tonë të parë. Cila është gjëja e parë që një Kohë e Qetë duhet të përfshijë? *(Leximi i Biblës)*

Pse mendon ti që është e rëndësishme të lexosh Biblën? *(Është Fjala e Perëndisë.)*

Saktë. Le të mendojmë për disa arsye se pse ti mund të dëshirosh të lexosh Fjalën e Perëndisë. Përgjigju këtyre tre pyetjeve të tjera ti vetë.

1. A dëshiron ti ta njohësh Perëndinë vërtet mirë? - atëherë ti duhet të lexosh Biblën.
2. A dëshiron ti të dish se çfarë Perëndia mendon për ty? - në Bibël Ai të lejon ty të dish se si je ti në të vërtetë përbrenda. Bibla na kujton ne që ndërsa njerëzit e tjerë mund të të shikojnë ty vetëm nga jashtë, Perëndia mund të shikojë zemrën tënde. Ai i di mendimet dhe dëshirat e tua. Ai di se pse ti bën gjërat që ti bën.
3. A dëshiron me të vërtetë të dish sesi Zoti Perëndi do që ti të jetosh? - Ai të tregon ty në Fjalën e Tij, Biblën.

Cilat janë tre arsyet për një të krishterë që të dojë të lexojë Biblën si një pjesë të Kohës së tij të Qetë?

Mësues, udhëhiqi fëmijët për të listuar sipër tre arsyet. Lejojeni një fëmijë të jetë gati për të lexuar Zbulesa 3:20 ose lexojeni vetë.

\_\_\_\_\_ do të lexojë Zbulesa 3:20 për ne. Ky varg do të na udhëheqë ne në të dhënë tjetër për të na ndihmuar që të zbulojmë atë çfarë do të ndodhë gjatë Kohës së Qetë. (*Lexoni vargun*).

Zoti Jezus thotë këtu që kur Ai vjen në jetën tënde, Ai do të "hajë darkë" me ty dhe ti me Të. Një përkthim tjetër i Biblës thotë "darkojë". Kjo do të thotë që Ai do të vijë dhe do të ndajë në jetën tënde, në gjithçka që ti bën. Ai interesohet për ty dhe Ai të do ty. Ai kujdeset për gjithçka që të ndodh ty dhe dëshiron që ti t'i tregosh Atij për gjithçka.

Si e quajmë ne bisedën me Perëndinë? (*Lutje*)

Saktë, dhe ky është numri dy në faqen tonë të të dhënave. Gjatë Kohës tënde të Qetë, ti dëshiron të dëgjosh kur Perëndia flet nëpërmjet Fjalës së Tij, por është gjithashtu një kohë për ty për t'i treguar Atij për ato gjëra që janë të rëndësishme për ty. Një Kohë e Qetë është një kohë për të ndarë. Është si një bisedë me një mik. Kur ti bisedon me Perëndinë në lutje, ti mund t'i tregosh Atij sesa shumë ti e do Atë dhe t'i kërkosht Atij të të tregojë ty gjëra të veçanta nga Fjala e Tij. Ti mund t'i kërkosht Atij të të ndihmojë ty dhe të të bekojë dhe të kujdesesh për të tjerët.

E dhëna jonë e tretë këtu është gjithashtu e rëndësishme. A e di se çfarë do të thotë fjala meditoj? (*Lejojini ata që kanë ide të ndajnë të parët.*)

Do të thotë të mendosh. Kur ti kalon kohë me Perëndinë në Kohën tënde të Qetë, ti nuk do të nxitosh, vetëm që të thuash u bë. Ti dëshiron të jesh një detektiv i mirë dhe të lejosh mjaft kohë

për të menduar me kujdes për çfarë lexove dhe çfarë t'i thuash Perëndisë në lutje. Ndoshta Perëndia ka diçka të veçantë që Ai do që të të tregojë ty. Ti duhet të dëgjosh dhe të mendosh dhe të lutesh ndërsa kërkon për të dhëna për të mësuar çfarë Ai do që ti të dish dhe të bësh.

## Pjesa II

### PSE TË KEMI NJË KOHË TË QETË?

Sot ne do të shqyrtojmë disa arsye më shumë për pasjen e një Kohe të Qetë. Pse duhet që një i krishterë të ketë një Kohë të Qetë? (*Lëri fëmijët të bëjnë disa sugjerime këtu.*)

Tani le të shikojmë në Bibël, Fjalën e Perëndisë, për dy arsye më shumë për pasjen e një Kohe të Qetë. Shembulli i parë që ne shikojmë është tek Mateu 4:3-4.

(*Lëreni një fëmijë të lexojë.*)

Në këtë kapitull të Biblës, ne shikojmë që Zoti Jezus kishte qenë shumë i zënë. Ai kishte bërë një mrekulli të madhe, duke ushqyer më shumë sesa 5000 njerëz vetëm nga pesë copë bukë dhe dy peshq të vegjël. Por kur mbaroi gjithçka, Ai i largoi dishepujt e Tij dhe madje edhe njerëzit që kishin parë mrekullinë. Pse e bëri Ai këtë? (*Ai donte të ishte plotësisht vetëm me Atin e Tij.*)

Kjo nuk ishte koha e vetme që Zoti Jezus kishte një kohë të veçantë vetëm me Perëndinë. Ti ke nevojë për kohë si këto, gjithashtu, kur mund të jesh plotësisht vetëm me Perëndinë me qëllim që të bisedosh me Të dhe ta dëgjosh Atë.

Sigurisht është mirë të shkosh në Shkollën e së Dielës dhe kishë ose në Klubin e Lajmit të Mirë për të qenë me të krishterët e tjerë. Këtu ne mund të mësojmë më shumë për Perëndinë dhe ta adhurojmë Atë së

bashku, por nëse ti dëshiron me të vërtetë që miqësia jote me Zotin Jezus të thellohet dhe të rritet, ti mund të kalosh kohë vetëm me Të, duke e njohur Atë.

A të është dashur ndonjëherë të ndërrosh shtëpinë ose të shkosh në ndonjë shkollë që është e re për ty? Në fillim nuk është e lehtë, sepse ti nuk njeh asnjë. Ti duhet të përpiqesh të bësh shokë ose shoqe me dikë. Pasi ke zënë miq ti mund të fillosh që me të vërtetë të kënaqesh me shkollën tënde të re.

Për tu bërë vërtet miq të mirë me dikë, ti duhet të kalosh shumë kohë duke biseduar së bashku dhe duke njohur njëri-tjetrin. Bërja e gjërave së bashku do të ndihmojë, gjithashtu.

Zoti Jezus do që ti të kalosh kohë për ta njohur Atë. Ai interesohet në gjithçka që ti bën dhe në çdo gjë që të ndodh ty. Sigurohu që të vendosësh mënjane kohë të veçantë për Të çdo ditë.

### **PJESA III**

---

## **Kur dhe ku të kemi një Kohë të Qetë**

Nëse ti je gati të fillosh që të kesh një Kohë të Qetë, ka dy pyetje të rëndësishme që ti duhet t'i përgjigjesh. E para është KUR duhet të kesh ti një Kohë të Qetë? (Tregoni kapakun)

Le të shikojmë shembullin e këtij djali. Kur është ai duke kaluar Kohën e Qetë? (orën 7 të mëngjesit)

Ai zbuloi që koha e tij më e mirë për të është madje përpara se ai të ngrihet nga krevati në mëngjes. Por është rreziku për të qëndruar në krevat në Kohën tënde të Qetë. A mund të mendosh se çfarë është? (Nëse ti je i përgjumur në mëngjes, ty mund të të zërë përsëri gjumi kur ti qëndron në krevat. Mund të ishte më mirë të

çoheshe nga krevati dhe të uleshe pranë një tavoline.)  
(*kthehuni tek faqja 3*)

Ndoshta do të jetë një kohë e mirë për ty - por mund të jetë një kohë tjetër që është më e mirë. Zoti Jezus shpesh ngrihej shumë herët për të qenë vetëm me Perëndinë. Por Ai, gjithashtu gjeti kohë të tjera ditën ose natën kur Ai mund ta bënte këtë.

Pra ti duhet të zgjedhësh një kohë që është më e mira për ty. Ndoshta përpara mëngjesit do të jetë një kohë e mirë, ose pas mëngjesit! Ndoshta edhe drejt pas shkollës ose mësimit, ose para ushqimit të mbrëmjes - ose edhe përpara se të shkosh në krevat!

Gjëja e rëndësishme është të kesh një kohë të veçantë, dhe është mirë nëse është e njëjta kohë çdo ditë, kështu që të bëhet një zakon i mirë dhe i rëndësishëm në jetën tënde.

A mund të mendosh për ndonjë kohë ose orë tjetër kur ti mund të kalosh Kohën tënde të Qetë? (*Lejojini ata të sugjerojnë orën.*)

Ne kemi parë kohë të ndryshme gjatë së cilës ti mund të zgjedhësh të kesh Kohën tënde të Qetë. Tani le të mendojmë përsëri. Pyetja jonë e dytë e rëndësishme është "KU duhet që ti të kalosh Kohën tënde të Qetë?" Dëgjoje këtë histori për një të krishterë të ri në atë çfarë duket si një situatë e pamundur. Gjej të dhëna që ti ke nevojë të të ndihmojnë ty të gjesh vendin e duhur për të pasur Kohën tuaj të Qetë.

Sara ishte më e vogla, në një familje me katër veta. Ajo kishte dy motra dhe një vëlla, të gjithë më të mëdhenj sesa vetja. Ajo ndante një dhomë me një nga motrat e saj. Kishte gjithnjë zhurmë dhe shtëpia e tyre ishte gjithnjë plot me lëvizje, me shokët e shoqet e tyre që hynin e dilnin pas

shkollës, dhe ngrënia e mëngjesit ishte gjithnjë me nxitim dhe gjithashtu për të kapur autobusin për në shkollë.

Në Klubin e Lajmit të Mirë, mësuesi kishte biseduar me ta sesa e rëndësishme ishte të kishe një Kohë të Qetë çdo ditë, nëse ata e donin Zotin Jezus dhe donin me të vërtetë ta njihnin Atë më mirë.

“Një Kohë e Qetë - në shtëpinë tonë?” mendoi Sara. “Kjo është e pamundur. Nuk ka kurrë një orë kur është qetë, dhe unë nuk mund të gjej një vend për të qenë vetëm!”

Pas Klubit një ditë, ajo qëndroi dhe foli me mësuesin e Klubit të Lajmit të Mirë për këtë.

“Sara,” tha mësuesi, “Le të lutemi për këtë, dhe t’i kërkojmë Perëndisë të tregojë ty një kohë kur ti me të vërtetë mund të jesh vetëm dhe qetë.” Kështu bënë ata. Ata u lutën së bashku, dhe më pas mësuesi premtoi të vazhdonte për t’u lutur për Sarën derisa ajo të gjente një vend.

Javën tjetër, Sara kishte lajme të mira për t’i thënë mësuesit. “Unë kam gjetur një kohë kur vëllai dhe motrat e mia më lënë vetëm, dhe ne të gjithë duhet të rrimë shumë të qetë ose shumë urtë. Kur ne bëjmë detyrat tona të shtëpisë pas darkës, mami na thotë ne të rrimë urtë, dhe të punojmë në dhoma të veçanta,” tha ajo. “Kështu që unë e pyeta atë, dhe ajo tha që unë mund ta filloj kohën time të detyrave të shtëpisë duke lexuar Biblën dhe duke u lutur! Kjo gjithashtu më ndihmon mua që t’i bëj detyrat e shtëpisë më mirë kur unë lutem në fillim!”

Si e gjeti më në fund Sara vendin e duhur?

1. Ajo shikonte dhe mendonte për një vend të qetë.

2. Ajo i kërkoj një të rrituri për ndihmë për të menduar për një vend.
3. Ajo u lut dhe i kërkoj Perëndisë t’i tregonte asaj.

Ndoshta ti duhet të mendosh shumë dhe të bësh disa punë prej detektivi për të gjetur tamam vendin e duhur ku ti mund të jesh vetëm dhe i qetë. Por nëse ti dëshiron me të vërtetë, Perëndia do të të ndihmojë ty të gjesh një kohë dhe një vend për të qenë vetëm me Të.

## **Pjesa IV**

---

### **Si të lexoni Biblën në Kohën tuaj të Qetë (1)**

*(Faqe 5)*

Ne kemi gjetur të dhëna për t’iu përgjigjur shumë pyetjeve për Kohën e Qetë, por pyetja e sotshme është shumë e rëndësishme. Është një gjë kur ne na thuhet sesa e rëndësishme është të bësh diçka, por përpara se ne të mund ta bëjmë me të vërtetë atë, ne duhet të mësojmë sesi ta bëjmë atë. Inkurajoj fëmijët të shkruajnë çdo hap në librin e të dhënave të detektivit të tij apo të saj.

Le të kujtojmë tre të dhëna që na tregojnë ne se çfarë është një Kohë e Qetë, për të na ndihmuar që të fillojmë të mësojmë sesi të kemi një Kohë të Qetë. Cilat janë këto tre gjëra që janë të rëndësishme për të bërë gjatë Kohës tënde të Qetë? *(Tregoni faqen një për përsëritje - lexo Biblën, lutu, medito.)*

*(Faqe 6)*

Së pari, ne do të mendojmë sesi të lexosh Biblën në kohën tënde të qetë me qëllim që ta lejosh Perëndinë të flasë me ty. Ka shtatë hapa. Ndërsa ne flasim për secilin nga këto hapa, sigurohu që të shkruash në librin tënd detektiv të të dhënave. Kush mund të lexojë të parin për ne? *(Lutu)*

Po, ne duhet të lutemi në fillim, përpara se të lexojmë Biblën. A e di se pse? Sepse është e rëndësishme për t'i kërkuar Perëndisë për të na ndihmuar të mendojmë për Të, dhe për të kuptuar Fjalën e Tij.

Ja ku është një lutje e marrë nga Bibla (Psalmi 119:18). "Hapi sytë e mi dhe unë do të sodit mrekullitë e ligjit tënd."

Ti mund të fillosh Kohën tënde të Qetë me një lutje të tillë, duke i kërkuar Perëndisë për të folur me ty nga Fjala e Tij.

Tani, le që dikush të lexojë hapin tjetër për ne...(Lexo)

Pasi ne jemi lutur, ne jemi gati të lexojmë dhe të zbulojmë çfarë Perëndia do që të na tregojë ne! Por si mund ta dish ku të lexosh? Bibla është një libër kaq i madh. Ku do të fillosh?

Mirë pra, nëse kurrë nuk e ke lexuar shumë Biblën më parë, do të jetë mirë të lexosh disa gjëra për Zotin Jezus, dhe sesi Ai jetoj kur Ai ishte këtu në tokë. (*Mësues, sugjero Ungjillin e Gjonit ose Markut.*) Leximi i një libri të tërë si ky, por sigurisht vetëm disa vargje çdo ditë, është një ide e mirë. Disa njerëz kanë një listë ose karton që i tregojnë atyre ku të lexojnë çdo ditë. Pra lexo disa vargje. Ndoshta lexo ato dy ose tre herë për t'u siguruar që i kupton ato.

Tani, hapi i tretë - kush mund të lexojë për ne? (*Mendo.*)

Po, mendo! A mund të kujtosh fjalën më të madhe që ne përdorim për këtë më parë?

(*Medito - shiko faqen 1*)

Ndërsa ti lexon vargjet për atë ditë, ti mund të mendosh për to duke bërë këto pyetje...

- A ka ndonjë të vërtetë të veçantë që unë mund të mësoj - ndoshta për

Perëndinë, ose veten time, ose për të tjerët?

- A ka ndonjë premtim të veçantë nga Perëndia, për mua për ta marrë si timin?

- A ka ndonjë shembull për mua për ta ndjekur ose për t'iu shmangur - një person i mirë apo i keq në histori?

- A ka ndonjë urdhër - diçka që Perëndia më tregon që t'i bindem?

- A ka ndonjë paralajmërim, një rrezik ose mëkat për t'u kthyer?

Ti mund të jesh detektiv i vërtetë duke përdorur pyetje për të të ndihmuar ty të gesh të dhëna në Fjalën e Perëndisë. Këto të dhëna do të të ndihmojnë ty të mësosh më shumë për Perëndinë dhe çfarë Ai do për ty. Herën tjetër, ne do të mësojmë hapa më shumë të rëndësishëm në leximin e Biblës për Kohën tënde të Qetë.

## Pjesa V

---

### **Si të lexosh Biblën në Kohën e Qetë (2)**

Herën e fundit ne filluam të bisedonim sesi të kemi një Kohë të Qetë. Pa e parë librin tënd të të dhënave, a mund të më tregosh tre hapat e para në leximin e Biblës tënde për Kohën tënde të Qetë? Cili është hapi i parë? (*Lutu*)

Saktë, së pari ti dëshiron t'i kërkuar Perëndisë të flasë me ty nëpërmjet asaj që ti lexon. Kërkoji Atij të të ndihmojë ty të përqendrohesh tek Ai dhe Fjala e Tij.

Cili është hapi i dytë? (*Lexo*) Kujto kur ti lexon një pasazh, ose pjesë të një kapitulli nga Bibla, ti mund të duash që të lexosh disa vargje dy ose tri herë. Çfarë duhet të bësh ndërsa lexon? (*Mendo për këtë.*) Ne përmendëm disa pyetje për të na ndihmuar të mendojmë për Fjalën e

Perëndisë ndërsa ne lexojmë. Cilat ishin disa nga këto pyetje? *(Lejoji fëmijët të përgjigjen dhe ju plotësoni atë çfarë ata nuk mund ta plotësojnë.)* A ka ndonjë premtim ose një të vërtetë të veçantë për mua për të mësuar? A ka ndonjë shembull të mirë në histori për mua për të menduar? A ka ndonjë urdhër për t'u bindur ose një paralajmërim rreziku ose mëkati?

Kur ti ke lexuar me kujdes dhe ke gjetur ose zbuluar një mendim të veçantë në këtë mënyrë, ti je gati për hapin tjetër. Çfarë është? *(Të lutesh përsëri.)* Herën e parë ti u lute që Perëndia të të ndihmojë të kuptosh fjalën e Tij por këtë herë ti do të lutesh për atë çfarë ke lexuar tashmë.  
*(Faqe 7)*

Supozo për shembull, që ti ke qenë duke lexuar historinë e Zotit Jezus ndërsa Ai shikonte njerëzit ose popullin që i vendosnin paratë e tyre në thesarin e tempullit. *(Mësues, lexo Markun 12:41-44)*

Ti mund të gjesh këtu një shembull për ta ndjekur. Kjo grua i dha gjithçka që ajo mund të jepte, Perëndisë. Ti mund të lutesh kështu: "Zoti Jezus, unë nuk kam shumë, por dua të jem si kjo grua dhe të jap gjithçka që mundem. Më trego sesi unë mund të ndjek këtë shembull."

Ose, ndoshta ti lexon për kohën kur Juda, një nga dishepujt e Zotit Jezus, vendosi ta tradhtonte Atë tek armiqët e Tij *(Lexoni Marku 14:10-11)*.

A mund të mendosh se çfarë mesazhi të veçantë ti mund të gjesh këtu? *(Lejoji fëmijët të përgjigjen.)* Mirë. Ndoshta ti gjete një shembull të keq për t'iu shmangur. Atëherë lutja jote mund të jetë:

"Zoti Jezus, të lutem më jep fuqi për të jetuar ashtu siç ti do që unë të jetoj, kështu që unë nuk do të të tradhtoj në ndonjë gjë Ty. Më ndihmo ta shmang

këtë shembull të keq sot, kështu që gjërat që unë bëj dhe them do të tregojnë që unë të dua Ty."

## **Pjesa VI**

---

### **Si të lexojmë Biblën në Kohën e Qetë (3)**

*(Mësues, përsëritni shkurtimisht tre hapat e dhëna në pjesën e mëparshme. Më pas vazhdoni).*

Pasi ti je lutur për leximin, a mund të na tregojë ndokush se çfarë vjen pastaj? *(Shkruaj)* Po, shkruaj mendimin tënd të veçantë me qëllim që ti do të kujtosh çfarë Perëndia të ka thënë ty.

Ti mund ta bësh në këtë mënyrë: *(Mësues, merrni një fletë letre në të cilën mund t'u tregoni fëmijëve sesi të fillojnë një fletore të Kohës së Qetë.)*

Në fillim të faqes tënde, shkruaj datën, dhe ku do të lexosh në atë ditë, p.sh. Marku 12:41-44 ose Marku 14:10-11.

Në rreshtin tjetër, vendos një titull, "Vendim i veçantë". Dhe më pas shkruaj vargun që veçanërisht nënkuptonte shumë për ty, dhe pak fjalë për atë çfarë ti u lute.

Tani, koha për hapin numër 6 - çfarë është? *(Mëso)*

Shikoje pasazhin edhe një herë. Lexo përsëri çfarë ke shkruar në fletoren tënde. Bëji pyetje vetes, "Çfarë mësova unë me të vërtetë? A ka diçka që Perëndia po më tregon mua që të bëj? A ka ndonjë mëkat në jetën time që unë duhet të ndal? Çfarë ka qenë Perëndia me të vërtetë duke më thënë mua?"

Ja sesi ne mësojmë nga Fjala e Perëndisë, ndërsa shikojmë nga afër atë çfarë Perëndia është duke na thënë ne.



Ti mund të dëshirosh gjithashtu të kalosh pak minuta këtu për të kaluar vargjet e tua përmendësh - që është diçka tjetër që Perëndia do që ne të mësojmë! Shkruaj ato çfarë ti ke mësuar me të vërtetë nga Koha jote e Qetë sot...dhe më pas ti je plotësisht gati për hapin e fundit. Çfarë është? (*Bindje*)

Po, ky hap i fundit është më i rëndësishmi nga të gjithë dhe ne gjejmë arsyen pse në Bibël. (*Lejohet fëmijët të lexojnë Jakobi 1:22*). Zoti Jezus do që ne të bëjmë çfarë Ai na tregon në Fjalën e Tij, kështu që Ai mund të ndryshojë jetët tona ditë për ditë dhe të na bëjë ne më shumë si Ai. Zoti Jezus gjithashtu thotë (Gjoni 14:21), nëse ti e do me të vërtetë Atë, ti do t'i bindesh Atij.

## Pjesa VII

---

### Përsëritje

Meqenëse është dhënë shumë mësimdhënie në Pjesën IV dhe V, ne sugjerojmë që ju ta përdorni këtë javë si një kohë përsëritje. Mund të bëhet me disa shembuj - duke i lënë fëmijët të marrin pjesë në leximin e pasazhit; duke gjetur mendimin e veçantë; duke menduar sesi zbatohet tek ta.

### Shembujt

Marku 10:35-37 Fëmijët mund të gjejnë një shembull të keq për ta shmangur - egoizmin

Marku 10:42-45 Një shembull i mirë për të ndjekur - qëndrimi i shërbëtorit

Marku 10:46-52 Një e vërtetë e veçantë - Jezusi i do dhe dëshiron të ndihmojë të gjithë - duke të përfshirë edhe ty.

Marku 16:9-15 Një urdhërim për tu bindur - çoje Ungjillin tek të gjithë.

Gjoni 14:1-6 Një premtim për tu pohuar si i imi.

- premtimi i qiellit v.2
- premtimi i kthimit të Krishtit v.3
- premtimi i shpëtimit për ata që vijnë tek Perëndia nëpërmjet Krishtit v.6

## Pjesa VIII

---

### Si të Lutemi

Çfarë është një Kohë e Qetë? (*Lërin fëmijët të përgjigjen: kohë e veçantë vetëm me Perëndinë për të lexuar Biblën dhe për tu lutur.*)

Saktë, është një kohë për të ndarë, kur ti dëgjon Perëndinë dhe kur ti flet me Të në lutje.

Ne kemi mësuar 7 hapat për leximin e Biblës tuaj. Sot ne do të flasim sesi të lutemi.

(faqe 8)

Unë dua që ju detektivë të dëgjoni informacionin që unë kam për një djalë të krishterë që quhej Aldo. Dëgjoni për ato çfarë ne mund të mësojmë për lutjen nga këto fakte.

Aldo ishte një djalë i krishterë. Ai kishte mësuar sesi të kishte një Kohë të Qetë, në Klubin e Lajmit të Mirë. Në fakt, ai lutej çdo ditë nëse kishte mundësi. Ai madje kishte bërë një listë lutjeje, dhe në të ai kishte shkruar emrin e çdo anëtari të familjes së tij. Vëllai i tij më i vogël nuk e kishte pranuar Zotin Jezus si Shpëtimtarin e tij, dhe Aldo ishte duke u lutur që ai shumë shpejt ta pranonte. Ai lutej për prindërit e tij gjithashtu. Ata ishin të krishterë, dhe ai e dinte që ata kishin nevojë për ndihmë dhe forcë çdo ditë për të jetuar për Perëndinë, ashtu si ai vetë.

Nën emrin e tij në listën e lutjes, Aldo kishte shkruar tre gjëra që ai veçanërisht donte që Perëndia ta ndihmonte atë tani...provimin e tij të shkollës, natyrën e tij të rrëmbyer, dhe dëshirën e tij për të shkruar në

Kampin e Verës. Ai e dinte që Perëndia ishte i interesuar në të gjitha këto gjëra dhe që Ai ishte në gjendje t'i përgjigjej lutjeve të tij.

Çfarë bëri Aldo që e ndihmoi atë të kishte një kohë të mirë në lutje? (*Ai bëri një listë lutjeje.*) A ke ti një listë lutjeje?

Çfarë lloj gjërash do të vendosësh ti në një listë lutjeje nëse ti do të bëje një të tillë? (*Lërimi fëmijët të japin ide - drejtojini ata siç është e nevojshme.*)

Oh, ka shumë gjëra për të cilat ne mund të lutemi - por a e kupton ti që shumica e këtyre gjërave që ne kemi përmendur janë gjëra që ne kërkojmë? A është kjo e vetmja lloj lutjeje që ekziston? A është ky lloj më i mirë?

Faqja tjetër në librin tonë do të na japë ne të dhëna për llojet e lutjes që ne mund të kemi në Kohën tonë të Qetë.

(*Faqe 9*)

Fjala e parë është "lavdërim". Në të vërtetë kështu duhet të fillojë. Jo thjesht me një listë gjërash për të cilat t'i kërkojmë Perëndisë.

Po, Perëndia është i madh dhe i mirë, Ai është i dashur dhe besnik për fëmijët e Tij. Ti mund ta lavdërosh Atë duke i treguar Atij sesa shumë ti e do Atë. Të lavdërosh Perëndinë është t'i japësh Atij një kompliment, t'i thuash Atij se çfarë mendon që është kaq e mrekullueshme për Të.

Çfarë vjen më pas? (*faleminderit*)

A je ti mirënjohës për të gjitha që Perëndia të ka dhënë ty dhe për shumë gjëra që Ai ka bërë për ty tashmë? Sigurohu t'ia thuash Atij. Sa herë që ti shikon se Ai i është përgjigjur lutjeve të tua, kalo kohë për ta falenderuar Atë për përgjigjet e Tij.

Pse mendon që ne kemi nevojë të përfshijmë një kohë për t'i treguar Perëndisë që ne na vjen keq? (*drejttoni*

*mendimet e fëmijëve ashtu siç është e nevojshme*).

A je ndier ndonjëherë sikur ti nuk doje të luteshe ose që ti nuk mund, edhe nëse je përpjekur? Ndosht zakonisht sepse ti ke bërë diçka të gabuar dhe ke nevojë që në fillim t'i tregosh Perëndisë që ty të vjen keq. Ti s'ke pse të dekurajohesh ose të ndihesh i mundur. Zoti Jezus të thotë ty çfarë të bësh. (*Lejoje dikë që të lexojë 1 Gjoni 1:9*)

Të rrëfesh do të thotë t'i tregosh Perëndisë për atë çfarë ti ke bërë; të pranosh që është mëkat dhe që është kundër Tij. Më pas Ai premtun të të pastrojë ty nga fjalët dhe veprimet e gabuara. Ai të fal ty kur ti kërkon. Më pas ti mund ta falenderosh Atë që të fali dhe të fillosh ta lavdërosh Atë përsëri.

Këtu ne vijmë tek fjala e fundit për lutjen, atë që ne e filluam me (*Lutu ose Kërko*). Por libri ynë e vendos në fund në listë - dhe këtu e ka vendin me të vërtetë! Megjithatë kjo nuk do të thotë që është e parëndësishme. Perëndia na do ne, dhe dëshiron të na ndihmojë ne, dhe Ai dëshiron që ne të sjellim kërkesat tona tek Ai.

## **Pjesa IX**

---

### **Çfarë më duhet mua për një Kohë të Qetë?**

Ne kemi shqyrtuar atë ÇFARË një Kohë e Qetë është dhe kemi parë tek të dhënat se PSE ti duhet të kesh një kohë të qetë dhe SESI të kesh një të tillë. A je gati për të filluar? Nëse ti je,

pyetjet e sotshme do të jenë të veçanta për ty.  
(Faqe 10)

Çfarë më duhet mua?

Para së gjithash, dhe më shumë e rëndësishme, ti ke nevojë për veten tënde! A e njeh me të vërtetë Zotin Jezus si Shpëtimtarin tënd? Nëse ti nuk e njeh, por ti ke pyetje sesi ti mund ta vendosësh besimin tënd tek Ai, unë do të jem i gëzuar të të tregoj këtë nga Fjala e Perëndisë pas orës së mësimi. *(Mësues, vendoseni veten në disponim për ata që kanë pyetje).*

Nëse ti ke pranuar Zotin Jezus si Shpëtimtarin tënd, unë kam një pyetje shumë serioze për ty. A do me të vërtetë të njohësh Zotin Jezus më mirë dhe të mësosh për të jetuar për Të? Kjo është e rëndësishme, përndryshe ti mund të ndalosh për të pasur një Kohë të Qetë. Nëse ti nënkupton punë, Perëndia do të të ndihmojë ty të jesh besnik për të pasur Kohën tënde të Qetë.

Kujto, ti ke nevojë për një VEND TË QETË dhe një KOHË TË VEÇANTË për kohën tënde për të ndarë me Perëndinë. Mendo për këtë dhe shkruaj në librin tënd kohën më të mirë dhe vendin më të mirë për ty për tu takuar dhe për të ndarë me Zotin Perëndi.

Tani ne jemi gati për të menduar për gjëra të tjera që ti ke nevojë për një Kohë të Qetë.  
(Faqe 11)

Ti ke nevojë për një Bibël. A ke një? *(Mësues, planifiko që më përpara atë çfarë ti do të sugjerosh për ata që nuk kanë një Bibël ose pjesë të shkrimeve).*

Bashkë me Biblën tuaj, është mirë të kesh një udhëheqës leximi të Biblës të një lloji. Kujto që unë ju kam thënë që disa njerëz e përdorin një listë për t'i thënë atyre ku të lexojnë në Bibël çdo ditë? Këto libra të vegjël Buka jonë e

Përditshme të tregojnë se ku të lexosh, dhe gjithashtu kanë një histori ose komente për të të ndihmuar të kuptosh leximin e Biblës çdo ditë. (Mësues, mbani broshura me Buka jonë e Përditshme në dispozicion. Këto mund të gjenden nga Shtypi CEF ose BUF, Kutia Postare 249 Durrës, Albania, ose nga zyrat lokale të BUFSh. Një sistem biblioteke për të dhënë hua funksionon mirë nëse ti ke disa tituj të ndryshëm në dispozicion. Fëmijë, kthejeni një libër në *fund të muajit dhe shkëmbeje për një tjetër*).

Më pas, ti do të kesh nevojë për fletoren tënde dhe lapsin. A mund të kujtosh se për çfarë është? *(Të shkruash mendime të veçanta, dhe çfarë ti ke mësuar).*

E saktë, është kaq e rëndësishme të regjistrohësh çfarë ne kemi mësuar, kështu që mund të bindemi për çfarë Perëndia na thotë që të bëjmë. Një fletore e Kohës së Qetë është diçka që ti do të duash ta mbash dhe ta ruash si thesar për një kohë të gjatë. Ti mund ta lexosh herë pas here, të kujtosh çfarë Perëndia të ka mësuar ose ka qenë duke të mësuar.

Tani varet nga ty! Ti ke dëgjuar sesi të kesh një Kohë të Qetë dhe ti ke mësuar shumë për këtë kohë të veçantë me Perëndinë. Ti madje ke edhe shënime në librin tënd të të dhënave për të të ndihmuar ty të kujtosh.

Por ti vetëm mund të kesh Kohën tënde të Qetë - asnjë tjetër nuk mund ta bëjë këtë për ty. Pse të mos fillojmë sot nëse nuk ke pasur tashmë një të tillë? Më pas, herën tjetër kur të bisedojmë për Kohën e Qetë, ti mund të na tregosh sesi shkoi, dhe ndoshta të ndash me ne diçka që Perëndia të ka mësuar nga Fjala e Tij e Mrekullueshme.

## **Pjesa X**

---

Shpenzoni një farë kohe duke dëgjuar raporte të atyre që kanë filluar një kohë të qetë. Përgjigjuni ndonjë pyetjeje që fëmijët kanë, dhe i drejtoni ata në kuptimin e tyre.

Lutuni që fëmijët, që të rrënjosen në ecjen e tyre të krishterë, dhe që një kohë e qetë të bëhet një zakon për gjithë jetën.

Jepni shumë ndihmë dhe inkurajim gjatë një periudhe kohore. Kujtoni se kërkon kohë që të rrënjosen zakonet e reja të sjelljes. Jini të durueshëm dhe të luteni!

## **Pjesa XI**

---

Përsërit faqet e vizualit të Kohës së Qetë shkurtimisht. Mbani Bibla dhe broshura të Bukës së Përditshme në dispozicion, dhe vazhdoni që të inkurajoni fëmijët që të vendosin një zakon për të pasur një Kohë të Qetë të përditshme.

Mos u habitni për të gjetur gjatë javëve të para që vetëm pak fëmijë janë duke pasur një Kohë të Qetë. Ose që ata që bëjnë, vetëm kujtojnë të bëjnë kështu 2 ose 3 herë në javë. Jini pozitivë! Lavdëroji ata për zhvillimin e tyre!

Leximi nuk është e lehtë për shumë fëmijë, kështu që ata kanë nevojë për shumë inkurajim. Edhe nëse ata vetëm lexojnë Biblën e tyre një herë ose dy herë në javë, kjo është shumë më e mirë sesa të mos e lexojnë fare!

## **Përmbledhje e Hapave për Këshillimin e Fëmijës që Dëshiron të Vijë tek Krishti** *(mbajeni në Biblën tuaj)*

### **Sigurohu që Fëmija të Kuptojë për:**

#### **Perëndinë**

Kush është Perëndia?

Perëndia na krijoi ne. Ai flet me ne nëpërmjet Biblës.

Perëndia është i shenjtë dhe i pastër. Ai na do ne.

#### **Mëkati**

Çfarë është mëkati?

Mëkati është të mos i bindesh urdhërimeve të Perëndisë. Është kundër Perëndisë.

Flisni për mëkate specifike

Fëmija është një mëkatar

Mëkati meriton dënimin

## **Shpëtimtari**

Kush është i vetmi që mund të largojë mëkatet e tua?

Perëndia Biri vdiq në kryq për mëkatarët.

Zoti Jezus u ringjall përsëri nga të vdekurit. Ai është Zoti i të gjithëve.

## **Shpjego Se Si të shpëtohesh:**

**Shpjego çfarë Zoti do që ne të bëjmë, dhe çfarë Ai do të bëj.**

**Përdorni një varg Biblik** (Gjoni 1:12; 3:16; 6:37; Veprat e Apostujve 16:31; Rom. 6:23 ose 10:13).

Çfarë dëshiron Zoti që ti të bësh?

Çfarë do të bëjë Zoti?

**Paralajmëroni për vështirësi**

**Pyesni: “A dëshiron që të vendosësh besimin tek Krishti, apo të presësh më mirë?”**

Inkurajoni fëmijën të lutet me zë të lartë (nëse është gati)

## **Flisni për Sigurinë e Shpëtimit**

Kthehu tek vargu i Biblës që ti përdore.

Flisni për një jetë të ndryshuar.

Tregoji atij çfarë personi i cili është duke besuar me të vërtetë tek Krishti mund të dijë.

## **Jepni (më vonë) disa Këshilla për Jetën e Krishterë**

Lexo dhe bindu Biblës tënde.

Bisedo me Perëndinë, Atin tonë Qiellor.

Tregoji të tjerëve çfarë Zoti ka bërë për ty.

Kërkoji Perëndisë të të falë ty kur ti mëkaton.

Takohu me të krishterë të tjerë.

Kujto që Zoti premton: “Unë nuk do të të lë.”